

STATUT
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Tafa 2023” shpk

Në Tiranë, sot më datë 02.08.2023, ne respektim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ligjit 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Aktin e themelimit, me cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë: **Z. Erjon Tafa**, atësia Durim e datëlindjes 08.06.1989, lindur në Fier dhe banues në Tirane, truga “3 Deshmoret”, Ndertesa 2, Shkalla 3, Apartamenti 12, Kashar, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr. 034887882 dhe numër Personal I90608096C **harton këtë statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “Tafa 2023” shpk**

KREU I

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet **“Tafa 2023”** shpk. Ajo është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Tafa 2023”** shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotat në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore ne adresën: Tirane Rruga e Dibres , numer pasurie 10/276-N21, Volumi 30, Faqe 202, ZK 8370. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale brenda edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakeve.



Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet në këto fusha:

Call center per sherbime dentare, Agjensi Udhetimesh Turistike.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga “ortaket” e shoqërisë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga “ortaku” i shoqërisë, **Z.Erjon Tafa** i cili eshte zotërues e 1(nje) kuote me vlerë 100 000 qe perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përpunje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Ortaket është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaket është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Ortaket, vendos për çështje si :

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë **Z. Erjon Tafa**, atësia Durim e datëlindjes 08.06.1989, lindur në Fier dhe banues në Tirane, rruga “3 Deshmoret”, Ndertesa 2, Shkalla 3, Apartamenti 12, Kashar, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr. 034887882 dhe numër Personal I90608096C.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakeve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaket;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të tregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra ortakeve te vetëm për miratim;
- e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



- f. kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Ortakeve edhe në rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrate të tatim taksave, autoriteteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojet ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët kishin dijeni që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në trethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12


Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pa miratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakeve që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, rreth përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të tregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblyejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14


Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rrëth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Eksperët



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividendi) që mbeten pas veçimit të fondevë ligjore të mësipërme dhe të atyre pët shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Ortakeve të shoqërisë.

Neni 17

Prishja e shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a. kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c. në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d. në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
 - e. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g. për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
 3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpermendura, ekzistanca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korriguar, nëse është e mundshme të korrigohet, dhe ky korigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkësës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvëçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë

se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqerinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqërítë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqërítë e përthihura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthihëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthihje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqërítë tregtare” ndryshuar me ligjin 129/2104.
3. Shoqërítë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:
 - a. kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
 - b. bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

- c. vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te tij në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipërsajt ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plete me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në ketë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut i shoqërisë “**Tafa 2023**” shpk, u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlera të njëjtë juridike dhe nënshkruhet me vullnetin e lirë e të plotë të “Ortakëve themelues”.

ORTAKU I SHOQËRISË

Erjon Tafa

Erjon Tafa

